



28 dhjetor 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA
Komuna e Mamushës të avancoj mbledhjen e të hyrave vetanake

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe gjatë muajit dhjetor ka shqyrtuar çështjen e arkëtimit të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2013.

Monitorimi ka nxjerrë në pah disa dobësi që ia pamundësojnë Komunës së Mamushës inkasimin më efektiv të hyrave vetanake. Vërejtje për këto çështje ka paraqitur edhe institucioni i Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e Pasqyrave Financiare të vitit 2012 (që mund të gjendet në: http://oag-rks.org/repository/docs/MAMUSHE_Report_ALB_660338.pdf).

Në këtë Raport thuhet se qysh në vitin 2011 ishte rekomanduar domosdoshmëria për adoptimin e një sistemi automatik të faturimit për të gjitha llojet e taksave dhe që të ndërmerren masa për rritjen e arkëtimit të taksave e ndryshme.

Drejtoria për Buxhet e Financa e Komunës së Mamushës ka ofruar pasqyrën e të hyrave që rrjedhin nga kategoritë e caktuara për periudhën janar-dhjetor dhe ka deklaruar se po bëhen përpjekje për avancimin e sistemit të faturimit dhe mbledhjes së të hyrave vetanake.

Sipas raportit të DBF-së, Komuna e Mamushës për vitin 2013 ka planifikuar që të inkasoj 60 mijë euro të hyra vetanake dhe deri në fillim të dhjetorit ka mbledhur afër 36 mijë euro, respektivisht 24 mijë euro më pak. Shprehur në përqindje realizimi i të hyrave vetanake ka qenë 59 për qind gjatë kësaj periudhe.

Inkasimi nga Taksat për veprimtari biznesore është vetëm 22 për qind, pasi që nga 7 mijë eurot e planifikuara janë inkasuar vetëm rreth 1 mijë e 500 euro.

Po ashtu inkasimi nga Participimet ka shënuar përqindje mesatare të realizimit, ngase nga 6 mijë e 500 euro të planifikuara janë inkasuar afër 4 mijë euro, respektivisht 57 për qind.

Ndërsa të hyrat nga pagesat e tatimit në pronë janë 15 mijë e 100 euro nga 15 mijë euro të planifikuara apo 101 për qind. Por në këtë kategori të hyrash, nuk ka sistem adekuat të regjistrimit të hyrave vjetore, për shkak të shumës së madhe të obligimeve të grumbulluara nga vitet e kaluara.

EC Ma Ndryshe përkujton edhe njëherë se Auditori ka gjetur se përveç tatimit mbi pronën, Menaxhmenti i Komunës së Mamushës nuk mban regjistra të veçantë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave dhe se pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhjes ose të ndjekë mbledhjen e të hyrave vetanake. Po ashtu Auditori ka identifikuar dobësi në sistemin e automatizuar të faturimi.

Bazuar në këto të gjetura EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Mamushës që:

- Të nis zbatimin e menjëhershëm të të gjitha rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm në lidhje me përmirësimin e inkasimit të hyrave vetanake;
- Të shtoj komunikimin me qytetarët në mënyrë që ata të ndërgjegjësohen se pagesa e obligimeve ndaj komunës mundëson shërbime më të mira dhe zhvillim të komunës së tyre;
- Të organizoj disa debate me bizneset e komunës, ku do të sqarohet nevoja e kryerjes së obligimeve dhe do të iniciohet dialogu ndër-sektorial.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Rr. Perandori Dioklician 14 Kati V (te Qafa), 10000 Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.